

M.F.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka depozituar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kërkesën për procedim disiplinor me masën “*Ulja e përkohshme e pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit*” ndaj magjistrates M.F., prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër më 25.04.2025.

KLP pezulloi procedimin disiplinor me arsyetimin se subjekti i procedimit ishte në proces rivlerësimi kalimtar.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë në mbledhjen plenare të dt.23.06.2025 me vendimin nr.115, ka vendosur përfundimin e procedimit disiplinor ndaj ish magjistrates M.F., pa një vendim përfundimtar. (M.F. kishte humbur statusin për shkak të largimit nga detyra gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, më 10.06.2025)